



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	01.11.2024
REFERENCË:	01-030/03-0071769/24
PËR/ZA/TO:	znj. Blerina Kastrati Idrizi - Udhëheqëse e Njësisë së Komunikimit me Publikun / Zyra e Informimit
Cc:	z. Bedri HAMZA, Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	znj. Teuta Selmani Pllana – Kryetare e Komisionit për Hartim e Ndryshim – Plotësim të Draft - Rregullores Komunale Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Shpallje e Diskutimit Publik

Me qëllim të nxitjes dhe sigurimin e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politikëbërjes dhe Vendimarrjes në Kuvendin e Komunës së Mitrovicës së Jugut, duke u bazuar në nenin 68 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; nenin 93 të Statutit të Komunës së Mitrovicës së Jugut Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020; Rregulloren (MAPL) Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës; nenin 29, paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komun, Komuna shpall:

DISKUTIM PUBLIK

(Për Hartim të Draft – Rregullores për Ndryshim – Plotësim të Rregullores Komunale Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale)

Njoftohen të gjithë qytetarët, grupet e interesit dhe palët tjera të interesuara që të marrin pjesë në Konsultim Publik, i cili do të mbahet ditën e hënë, me datë **11.11.2024**, në Sallën e Mediave të Komunës, duke filluar nga ora **10:00 h**.

Duke pasur parasysh rëndësinë e Hartimit të Draft – Rregullores për Ndryshim – Plotësim të Rregullores Komunale Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale, pjesëmarrja në këtë fazë të procesit është e nevojshme, prandaj të gjithë të interesuarit e tjerë nga dita e publikimit të këtij Njoftimi, të gjitha komentet, vërejtjet dhe sugjerimet mund t'i japin përmes e-Mail adresave elektronike tek Kryetarja e Komisionit për Hartimin e Draftit të Rregullores: teuta.selmani@rks-gov.net.

Bashkangjitur gjeni Draft-Rregulloren për Ndryshim – Plotësim të Rregullores Komunale Nr. 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale.